



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina**



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

nga dëgjimet publike, për planifikimin e buxhetit për vitin 2026, mbajtur më 5.8.2025, i cili filloi në orën 14:00.

Të pranishëm ishin: Valbona Makolli – drejtore e Drejtorisë së Financave, Samir Shahini - drejtor në Drejtorinë e Arsimit, Bekim Gashi – drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Valbona Vitija - drejtore në Drejtorinë e Administratës dhe dy zyrtarë nga Drejtoria e Arsimit.

Në diskutim mori pjesë edhe qytetari: Isa Rexha,

Diskutimin me qytetarë e kryesoi Osman Bllaca: përshëndes për të gjithë, ju falënderoj që jeni përgjigj ftesës. Sot mbahet diskutimi publik me drejtorët e shkollave të 3 niveleve parafillor, fillor dhe të mesëm, si dhe qytetarët e tjerë të pranishëm. Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit janë të ftuar edhe drejtorë tjerë që puna e shkollave ngërthehet me drejtoritë tjera: si Drejtoria e Shërbimeve Publike, Investimet Kapitale, dhe Shërbimet Administrative që kërkohen për shkolla. Mundeni me i shpalos kërkesat që i keni, që mund të inkorporohen për vitin 2026.

Sami Shahini, drejtor i arsimit: - ai i përshëndeti të gjithë dhe kërkoi propozim për një keqkuptim në informim nëse mundemi me e shty takimin për ditët në vijim për mosnjoftimin e drejtorëve të shkollave, pasi që s'ka qenë në dijeni për thirrjen e drejtorëve të shkollave, do të bëjmë një njoftim tjetër me kohë më serioz sepse shkollat se kanë marrë si njoftim.

Osman Bllaca: - tha që mos të shtyhet takimi, po nesër të mbahet nga ora 1 diskutimi me drejtorët e shkollave. Ndërsa ju që jeni të pranishëm do vazhdoni të paraqiteni kërkesat tuaja.

Valbona Makolli, drejtoreshë në Drejtori të Financave: - ligjërisht kërkohet 2 javë njoftimi me kohë dhe çdo dytën ditë kam bërë rikujtim. Nesër janë personeli i shëndetësisë dhe QMF me qytetarë, të enjten bashkësitë lokale dhe lagjet e ndryshme, të premtën kuvendet dhe anëtarët e lagjeve, asamblastët që munden me marr pjesë, nëse pajtoheni për një orë s'ka problem unë jam këtu mundemi me diskutuar, ose të vini me bashkësitë lokale të enjten, i dëgjojnë arsimtarët dhe vetë i paraqesin kërkesat e tyre.

Drejtoresha në shkollën Barilevë: - i përshëndet të gjithë, si çdo shkollë edhe shkolla jonë i ka kërkesat e veta, unë edhe me drejtorin dhe komunitetin e kam biseduar se infrastruktura e

shkollës është primare për ngritjen e cilësisë nëpër shkolla. Kemi fatin që shkolla në fshatin Barilevë do të fillojë me mësim gjithëditor, është shkolla e parë në rajon që do të prijë. Kanë filluar me rregullimin që 10 ditë për problemet ose mangësitë që munden me qenë në shkollë. Problemi që neve na shqetëson është një parking që e kemi bërë kërkesën kaherë prapa shkollës, ku komuniteti i sjell fëmijët në shkollë ku çdo ditë rrezikohen ata fëmijë kur prind i lë para dyerve të shkollës. Kam bërë edhe kërkesë për dyert e oborrit të shkollës që janë primare të rregullohen këto dyer. Unë jam çdo ditë në shkollë, as në pushim s'kam shkuar, afër 4-5 ditë edhe vetë kam qenë e rrezikuar nga një tubë qensh. Dyert janë primare, ndriçimi i oborrit të shkollës është primar dhe parkingu, ndërsa për të tjerat s'mundem me u ankuar se si shkollë jemi të kënaqur me punën e drejtorit të arsimit me Drejtor Samirin, ku deri sot asnjë kërkesë e vetme nuk është anuluar, falemnderit drejtor shumë.

Isa Rexha, kryetar i Bashkësisë lokale Barilevë: - unë i kam 3 kërkesa: një çerdhe në Barilevë i numëron 6537 banorë. E kam lut ish-drejtoreshën që ka qenë me herët, me ka thënë së i ka dështuar një çerdhe në Kolovisë po e bëjnë inventarin me gjete një klasë në Barilevë dhe me vendos çerdhen vitin e kaluar. Dje e kisha një takim me mërgimtarët dhe me kanë lutur që komuna të na jap lokacionin dhe planin, ne do e ndërtojmë vet çerdhen. Parkingun nëse është mundësia me u rregullu edhe ndriçimi i jashtëm me u rregulluar, ndërsa për dyer tash e dëgjova drejtoreshën s'kemi bërë kërkesë për dyer. Ju falemnderit!

Drejtoresha në shkollën Barilevë: - sa i përket çerdhes, unë para 3 viteve jam në postin e drejtores dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Ministrinë e Arsimit dhe Organizatën Joqeveritare "Save the children" kemi bërë hapje brenda shkollës, kemi plotësuar kushtet socializmi i fëmijëve në qendër, ku grupmoshat janë 3-5. Barileva me 6500 banorë, mëse të nevojshme dhe primare e ka hapjen e një çerdheje, oborri i shkollës i plotëson kushtet për hapjen e çerdhes në fshat ku në 75% e popullatës janë të punësuar femrat, dhe meshkujt. Në Besi është çerdhja po nuk i plotëson nevojat e fshatit Barilevë dhe Prugocit, ne s'po e hapim çerdhen vetëm për Barilevën, por i përfshijmë edhe fshatrat përreth. Kushtet i plotësojmë, tokë kemi në oborr të shkollës, ne kemi nevojë vetëm për një dritë të gjelbër nga Drejtoria e Arsimit, punojmë me donacione siç kemi punuar. Barileva është një vend ku mbahet fjala për fëmijët të gjithë kanë me dhënë donacione.

Samir Shahini: - falënderoi drejtoreshën për ndihmën në mësimin tërëditor në Barilevë, dhe të komunitetit. Ne do të mbajmë një takim me banorët e fshatit në ditët në vijim dhe do ju tregojmë si zhvillohet mësimi tërëditor, jemi duke e bërë në të gjitha fshatrat dhe shkollat që do i bashkëngjiten mësimi tërëditor, rreth pyetjeve dhe paqartësive që i kanë. Drejtoresha i përmendi disa investime që kemi filluar aty, do e vendosim një qendër për trajtimin dhe zhvillimin mbrenda shkollës si donacion WMCA, jemi në pritje të një marrëveshjeje me ta 3 shkolla, një filllore 2 të mesme dhe njëra në filllore ose e vetmja është Shkolla "Ali Kelmendi". Kemi biseduar bashkë drejtoreshë cilën hapësirë me ia dhënë. Duhet me shiku nëse pjesa për çerdhe mjafton oborri do e shohim me Arbërinë, ndoshta do shikojmë për të saktësuar edhe prej Drejtorisë së Pronës dhe me e pa edhe afatin e kërkesave që pranon Ministria e Arsimit, nëse ka afat të hapur besoj që mundemi me i dërgu parcelën si lokacion, si ndarje pa prit me e vendos në buxhet për vitin tjetër, ata edhe ashtu po thonë kanë para mjaft në pritje dhe s'po gjejnë toka me ndërtuar çerdhe në Prishtinë. E kanë ata projektin e çerdheve tipike, sa e di unë e kanë të gatshme. Të njëjtin model e pata në mendje që e kanë edhe në Bardhosh nëse nuk gaboje është për 100 fëmijë besoj që mjafton dhe për Barilevë i njëjti koncept. Për këtë pjesën e parcelës për çerdhe e shohim a mjafton së duhet me ardh edhe në terren me pa tani me Drejtorin Brahim me gjet prej Drejtorisë së Pronës a ka ndonjë mundësi me nda një pjesë të oborrit. Nëse vendosim me ec më shpejtë këtë vit, nëse jo atëherë ju si bashkësi lokale mundeni

me na ndihmu me gjete ndonjë parcelë tjetër. Drejtoreshë kur ishim me juve në vizitë bashkë me Arbërin e kemi lënë që mundemi me bë një vlerë vetëm që mundeni me llogarit me kuotim të shpejtë deri në një mijë euro a mundemi me e rregulluar atë pjesën e derës, e vendosim në atë procedurë nëse jo atëherë e vendosim ndonjë procedurë tjetër.

Drejtoresha në shkollën Barilevë: - drejtor me ato një mijë euro e kam pa që mundemi me e rregulluar, duhet me qenë 3 kontrata - oferta, për atë s'kam bë kërkesën.

Samir Shahini: - pjesa e fundit të parkingu në oborr të shkollës, se di sa është e nevojshme me pas parking në oborin e shkollës.

Drejtoresha në shkollën Barilevë: - edhe mësimdhënësit i kemi që udhëtojnë një pjesë me automjete, po edhe prindërit i sjellin dhe i marrin fëmijët.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2026,
5 Gusht, 2025
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	1.139	Herby	K. L. L.		
2	Redi	Shkalla	Shkalla	redix.shkalla@gmail.com	
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen! *